



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1512 Prot.

Roskovec, më 26.12 2019

VENDIM

Nr. 112 datë 20/12/2019

PËR

ANULIM TË VENDIMIT NR.97 DATË 23.10.2019
“NDËRTIM I PARKUT AGROTURISTIK DHE REHABILITIMI I RRUGËS
HYRËSE TË FSHATIT LUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 29 shkronja a, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 113, shkresës Nr.1682/4 date 20.11.2019 të Prefektit të Qarkut Fier, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Anulimin e VKB Nr.97 datë 23.10.2019 “Ndërtim i Parkut Agroturistik dhe rehabilitimi i rrugës hyrëse të fshatit Luar”.
Në shkresën Nr.1682/4 datë 20.11.2019 “Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec” Prefekti i Qarkut Fier konstaton se objekti i këtij vendimi nuk është kompetencë e këshillit bashkiak në bazë të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar neni 29 shkronja a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

